



Në përgjigje të kërkesës (Aplikimit nr. 2472, datë 27.10.2014), ZVRPP, Gjirokastrë, pas afro dy vjetëve, ka nxjerr Akt verifikimin nr.373 Prot, datë 21.03.2016, duke kërkuar z.D të plotësoj dokumentacionin, pasi në Printimet 1, 2, 3, nuk figurojnë emri i tij i trajtuar me AMTP.

Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar prej ZVRPP, Gjirokastrë, dërguar me shkresën nr. s'ka, datë 29.05.2017, prej Këshillit të Qarkut, Gjirokastrë, DAMT, ankuesi, rezultoi të ketë aplikuar përsëri (Aplikimi nr.2253, datë 31.05.2017), me tarifë zero, për marrjen e dokumentacionit të pronësisë për pasuritë e fituara në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr.2726, datë 25.12.1992.

Në përgjigje të kërkesës (Aplikimi nr.2253, datë 31.05.2017) të kryer prej z.D, ZVRPP, Gjirokastrë, me Akt verifikimin nr.1237, datë 01.08.2017, drejtuar atij, shprehet se:

*“Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur me tarifë zero, ju duhet të prisni regjistrim me akt administrative sipas shkresës të DAMT, nr. s.ka, datë 29.05.2017.*

*Nga kontrolli manual në listat e printimit 1, 2, 3, nuk figurojnë asnjë person me emrin S.D. Drejtohuni gjykatës për regjistrimin e pasurive”.*

Qëndrimin e shprehur prej ZVRPP, Gjirokastrë në procesin e trajtimit të kërkesës së ankuesit S.D. për marrje dokumentacioni pronësie mbi pasuritë e fituara në pronësi prej familjes së tij, sipas AMTP Nr.2726, datë 25.12.1992, të dhënë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Dervician, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë, nuk e gjejmë të bazuar në ligj, përkundrazi e gjejmë në kundërshtim me parashikimet e kryera në nenin 25, 32, 38, 45, 59, 70 të ligjit 33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar.

Ndodhur në kushtet e dërgimit me shkresën nr. s'ka, datë 29.05.2017, nga ana e Këshillit të Qarkut, Gjirokastrë, DAMT, të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr.2726, datë 25.12.1992, të dhënë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Dervician, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë, si dhe gjithë akteve të tjera të parashikuara në nenin 25 të ligjit 33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar, apo ligjin nr.8752, datë 26.03.2001 *“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave dhe administrimin dhe mbrojtjen e tokës”*, të ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.2, datë 08.04.2009 *“Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”*, të ndryshuar, kuptohet se, veprimtaria e ZVRPP, Gjirokastrë, nuk vjen në respektim të parimit për zhvillimin e një procesi të regullt ligjor, parimit të ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në nenet 4, 13 dhe 15 të Kodit të Procedurës Administrative.

Për shkaqet e bëra të ditura, në cilësinë e organit i cili ushtron të gjitha detyrat e nevojshme për sigurimin e mirëfunksionimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, neni 17/k i ligjit 33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar, është e nevojshme ushtrimi nga ana juaj i kontrollit mbi veprimatrinë e ZVRPP, Gjirokastrë, lidhur me çështjen e prezantuar me qëllim rivendosjen në vend të së drejtës së ankuesit si dhe vënia para përgjegjësisë të cilitdo punonjësi i cili do të rezultoj në shkelje të detyrave dhe funksioneve të ngarkuar në procesin e dhënies së shërbimit të kërkuar prej shtetasit S.D.

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë*

*rekomandime dhe të propozoje masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.*

## **REKOMANDOJMË**

*Ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Gjirokastrë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit S.D.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkresë.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë:*

*Kopje të shkresës nr.4784/1 Prot, datë 14.08.2017, të ZVRPP, Gjirokastrë, drejtuar Avokatit të Popullit.*

*Ekstrakt i Bankës “Credins”, datë 27.10.2014, për pagimin prej z.S.D, të shumës 28.000 Lekë në favor të ZVRPP, Gjirokastrë.*

*Kopje të Aplikimit nr. 2472, datë 27.10.2014, kryer prej z. S.D, në ZVRPP, Gjirokastrë.*

*Kopje të kërkesë për plotësim dokumentacioni (Akt verifikimi) nr. 373, datë 21.03.2016, i ZVRPP, Gjirokastrë, drejtuar z. S.D.*

*Kopje të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr.2726, datë 25.12.1992, të dhënë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Dercivian, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë, në favor të Familjes së z. S.D.*

*Fragment i rregjistrimit “Dokumete te dala” i ZVRPP, Gjirokastrë.*

*Çertifikatë Familjare e Familjes së z. S.D, datë 01.08.1991, lëshuar prej ZGJC, Dropull i Poshtëm, Gjirokastrë.*

*Dy Vërtetime Datë 20.10.2014, të lëshuar prej Komuna Dropull i Poshtëm.*

*Kopje të Aplikimit nr. 2253, datë 31.05.2017, kryer prej z. S.D, në ZVRPP, Gjirokastrë.*

*Kopje të shkresës nr. s’ka, datë 29.05.2017, të Këshillit të Qarkut, Gjirokastrë, DAMT, drejtuar ZVRPP, Gjirokastrë.*

*Kopje të “Lista e familjeve që marrin tokë në pronësi”, Parcela 39, 49, 65, të Fshatit Dercivian, Gjirokastrë, dërguar prej Këshillit të Qarkut, Gjirokastrë, pranë ZVRPP, Gjirokastrë (së bashku me hartat treguese).*

*Kopje të kërkesë për plotësim dokumentacioni (Akt verifikimi) nr. 1237, datë 01.08.2017, i ZVRPP, Gjirokastrë, drejtuar z. S.D.*

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Ermir KAPEDANI**

**Konceptoi dhe Daktilografoi**

**A.Gjoleka**